

STANFORD UNIVERSITY Fleta Informacionit Kërkimor

Drejtuesi
Protokollit:: Ari Kelman

IRB Use Only

Approval Date: July 15, 2026
Expiration Date: Does Not Expire

Titulli Protokollit: Good Faith Tech?

IRB# 86294

PËRSHKRIMI: Jeni të ftuar të merrni pjesë në **një studim kërkimor** mbi mënyrën se si njerëzit e përdorin dhe mendojnë për teknologjinë, përfshirë inteligjencën artificiale, dhe se si këto përvoja mund të lidhen me fenë dhe spiritualitetin. Nëse pranoi të merrni pjesë, mund t'ju kërkohet të merrni pjesë në një bisedë ose intervistë rreth përvojave dhe këndvështrimeve tuaja për këto tema. Intervista mund të jetë formale ose joformale dhe mund të zhvillohet personalisht, me telefon ose online. Me lejen tuaj, intervista mund të regjistrohet me audio ose video për të ndihmuar në transkriptimin dhe analizën e saktë. Nëse nuk dëshironi të regjistroheni me audio ose video, mund të merrni pjesë përsëri në studim.

Me lejen tuaj, kërkuesit mund t'ju vëzhgojnë gjithashtu ju ose aktivitetet përreth jush në mjedise përkatëse në terren, si konferenca, evenimente, faltore ose vende të tjera që lidhen me studimin. Këto vëzhgime mund të përfshijnë mbajtjen nga kërkuesit të shënimeve në terren, të shkruara me dorë ose të daktilografuara. Nëse kërkuesit dëshirojnë të lidhin vëzhgimet për ju me intervistën tuaj ose me informacione të tjera që jepni, ata do t'ju kërkojnë lejen.

Me lejen tuaj, kërkuesit mund të mbledhin gjithashtu të dhëna, përfshirë foto ose video, të hapësirave, objekteve, aktiviteteve, rriteve ose materialeve të tjera përkatëse për të kontekstualizuar më mirë intervistën tuaj ose mjedisin në terren. Kërkuesit mund t'ju kërkojnë gjithashtu lejen për t'ju fotografuar ose regjistruar me video ju, ose një objekt, aktivitet a rit të lidhur me ju. Ju mund të refuzoni të fotografoheni ose regjistroheni me video dhe përsëri të merrni pjesë në pjesë të tjera të studimit. Kërkuesit mund të bëjnë gjithashtu fotografi ose video të hapësirave ose aktiviteteve në grup ku individët nuk janë të identifikueshëm. Nëse dikush kapet rastësisht në një fotografi ose video dhe nuk ka dhënë leje për t'u fotografuar ose regjistruar me video, kërkuesit do të fshijnë, kur është e mundur, imazhin ose regjistrimin, do të bëjnë një version tjetër pa individë të identifikueshëm, ose do të heqin informacionin identifikues, për shembull duke turbulluar fytyrat ose tipare të tjera identifikuese.

Regjistrimet, fotografitë, videot, shënimet në terren dhe materialet e tjera të studimit do të përdoren vetëm për qëllime kërkimore. Regjistrimet, fotografitë ose videot e identifikueshme nuk do të ndahen publikisht pa lejen tuaj shtesë të shprehur qartë. Materialet e studimit do të ruhen në mënyrë të sigurt. Regjistrimet audio dhe video të identifikueshme do të fshihen brenda një viti pas përfundimit të studimit.

KOHA E ANGAZHIMIT: Pjesëmarrja juaj do të zgjasë përafërsisht 45–90 minuta për një intervistë. Nëse merrni pjesë në seanca të shumta, koha e përgjithshme e pjesëmarrjes nuk do të kalojë përafërsisht 12 orë gjatë gjithë studimit. Vëzhgimi ose pjesëmarrja në terren, nëse zbatohet, mund të ndodhë gjatë evenimenteve ose aktiviteteve ku ju tashmë po merrni pjesë.

RREZIQET DHE PËRFITIMET:

STANFORD UNIVERSITY Fleta Informacionit KërkimorDrejtuesi
Protokollit: Ari Kelman*IRB Use Only*Approval Date: July 15, 2026
Expiration Date: Does Not Expire

Titulli Protokollit: Good Faith Tech?

IRB# 86294

Rreziqet e lidhura me këtë studim janë minimale. Disa pyetje mund të përfshijnë besime personale, përvoja fetare ose shpirtërore, përvoja me teknologjinë ose inteligjencën artificiale, përvoja në punë ose komunitet, shëndetin mendor, vetminë, pikëllimin, shqetësimin ose tema të tjera të ndjeshme. Këto pyetje mund të shkaktojnë siklet. Ju mund të anashkaloni çdo pyetje ose të ndërprisni pjesëmarrjen në çdo kohë.

Ekziston gjithashtu një rrezik i mundshëm i humbjes së konfidencialitetit. Nëse informacioni që ndani do të zbulohet jashtë kontekstit kërkimor, ai mund të krijonte dëme sociale, reputacionale, profesionale, në punësim ose të lidhura me komunitetin. Për shembull, të tjerët mund të reagonin negativisht ndaj informacionit rreth besimeve tuaja fetare ose shpirtërore, përvojave tuaja me inteligjencën artificiale, përvojave tuaja në punë ose komunitet, ose çështjeve të tjera personale.

Ekipi kërkimor do të marrë masa për të reduktuar këto rreziqe. Të dhënat e studimit do të ruhen në mënyrë të sigurt, në përputhje me standardet e Universitetit Stanford. Kërkuesit do të zhvillojnë intervistat ose bisedat në mjedise private ose gjysmë-private kur është e mundur, do të kufizojnë mbledhjen e informacionit identifikues dhe do të de-identifikojnë shënimet, transkriptet, botimet dhe prezantimet si parazgjedhje, përveçse kur ju jepni leje të shprehur qartë për t'u identifikuar. Ju mund të refuzoni t'i përgjigjeni çdo pyetjeje, të refuzoni të regjistrohemi ose fotografoheni, ose të ndërprisni pjesëmarrjen në çdo kohë.

Përfitimet që mund të pritët me arsye të rrjedhin nga ky studim janë kryesisht shoqërore, përkatësisht që ky kërkim mund të kontribuojë në një kuptim më të gjerë të mënyrës se si njerëzit angazhohen me teknologjitë në zhvillim. **Ne nuk mund dhe nuk garantojmë ose pretojme se ju do të merrni ndonjë përfitim nga ky studim.**

PAGESAT: Ju nuk do të merrni pagesë për pjesëmarrjen tuaj.

TË DREJTAT E PJESËMARRËSIT: Nëse e keni lexuar këtë formular dhe keni vendosur të merrni pjesë në këtë projekt, ju lutemi kuptoni se **pjesëmarrja juaj është vullnetare dhe ju keni të drejtën të tërhiqni pëlqimin tuaj ose të ndërprisni pjesëmarrjen në çdo kohë pa ndëshkim ose humbje të përfitimeve për të cilat keni të drejtë ndryshe. Alternativa është të mos merrni pjesë.** Ju keni të drejtën të refuzoni t'u përgjigjeni pyetjeve të caktuara. Rezultatet e këtij studimi kërkimor mund të prezantohen në takime shkencore ose profesionale ose të botohen në revista shkencore. Privatësia juaj individuale do të ruhet në të gjitha të dhënat e botuara dhe të shkruara që rrjedhin nga studimi. Në përputhje me normat shkencore, të dhënat nga ky studim mund të përdoren ose ndahen me kërkues të tjerë për kërkime të ardhshme (pas heqjes së informacionit personal identifikues) pa pëlqim shtesë nga ju.

MBROJTJA E TË DHËNAVE TUAJA PERSONALE (GDPR):

Ne do të mbledhim të dhënat tuaja personale për këtë studim, përfshirë të dhëna që lidhen me shëndetin tuaj dhe/ose të dhëna të tjera personale të ndjeshme siç përshkruhet në këtë formular pëlqimi. Këto të dhëna i quajmë “të Dhënat tuaja të Studimit.” Çdo e Dhënë

STANFORD UNIVERSITY Fleta Informacionit Kërkimor

Drejtuesi
Protokollit:: Ari Kelman

IRB Use Only

Approval Date: July 15, 2026

Expiration Date: Does Not Expire

Titulli Protokollit: Good Faith Tech?

IRB# 86294

Studimi nga ky kërkim që kryhet në Bashkimin Evropian/Zonën Ekonomike Evropiane (BE/ZEE) do të mbliidhet, ruhet, përdoret dhe ndahet (përpunohet) siç kërkohet nga legjislacioni i BE/ZEE i njohur si Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (“GDPR”). Të Dhënat tuaja të Studimit mund të përpunohen për arsytet (qëllimet) e mëposhtme:

- për të kryer dhe konfirmuar saktësinë e studimit;
- për të na ndihmuar të monitorojmë dhe të sigurojmë që studimi po ndjek praktikatat më të mira kërkimore;
- për të bërë raportet e kërkuara pranë agjencive rregullatore vendase dhe të huaja dhe zyrtarëve qeveritarë që kanë detyrën të monitorojnë dhe mbikëqyrin studime si ky; dhe,
- për të zbatuar ligjet dhe rregulloret në fuqi, përfshirë kërkesat që të dhënat nga ky studim, pa informacion që mund t’ju identifikojë drejtpërdrejt, të vihen në dispozicion të kërkuesve të tjerë që nuk janë të lidhur me sponsorin e studimit ose ekipin e studimit. Për shembull, autoritetet rregullatore në disa vende mund të kërkojnë që të Dhënat tuaja të Studimit, pa informacion që mund t’ju identifikojë drejtpërdrejt, të bëhen publikisht të disponueshme në internet ose në mënyra të tjera, për t’i bërë të dhënat kërkimore më gjerësisht të disponueshme për kërkuesit e tjerë.

Personat dhe organizatat e mëposhtme mund të përpunojnë të Dhënat tuaja të Studimit për qëllimet e listuara më sipër:

- ekipi i studimit, përfshirë persona të tjerë dhe organizata që ndihmojnë ekipin e studimit:
 - Ari Kelman
 - Michelle Bao
 - Parth Sarin
 - Hana Spahia
- komiteti i etikës ose bordi institucional i rishikimit që miratoi këtë studim; dhe
- agjencitë rregullatore vendase dhe të huaja dhe zyrtarët qeveritarë që kanë detyrën të monitorojnë ose mbikëqyrin studime si ky.

Ne mund ta zhvillojmë studimin në Shtetet e Bashkuara dhe në vende të tjera ku ligjet nuk e mbrojnë privatësinë tuaj në të njëjtën masë si ligjet në vendin ku ju jetoni (banoni). Të Dhënat tuaja të Studimit mund të transferohen në këto vende për qëllimet e përshkruara më sipër. Ne do të marrim masa të arsyeshme për të mbrojtur privatësinë tuaj, në përputhje me ligjet në fuqi. Për shembull, kur është e përshtatshme, ne lidhim marrëveshje për transferimin e të dhënave me klauzola standarde kontraktuale të miratuara nga autoritetet evropiane, të cilat parashikojnë kushte të caktuara për mënyrën se si të Dhënat tuaja mund të përdoren dhe ndahen. Këto marrëveshje për transferimin e të dhënave ndihmojnë të sigurohet që të Dhënat tuaja të Studimit të mbrohen në mënyrë të përshtatshme.

Të drejtat tuaja dhe ruajtja e të dhënave: GDPR ju jep të drejta të caktuara në lidhje me të Dhënat tuaja të Studimit, përfshirë të drejtën për: (1) të kërkonit qasje, korrigjim ose fshirje të të Dhënave tuaja të Studimit, (2) të kundërshtoni ose kufizoni përpunimin tonë

STANFORD UNIVERSITY Fleta Informacionit Kërkimor

Drejtuesi
Protokollit: Ari Kelman

IRB Use Only

Approval Date: July 15, 2026
Expiration Date: Does Not Expire

Titulli Protokollit: Good Faith Tech?

IRB# 86294

të të Dhënave tuaja të Studimit, dhe (3) të kërkonit që ne të zhvendosim, kopjojmë ose transferojmë të Dhënat tuaja të Studimit te një organizatë tjetër. Për të bërë çdo kërkesë të tillë, ju lutemi kontaktoni Studiuesin Kryesor në aykelman@stanford.edu.

Ju gjithashtu mund ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë. Nëse e tërhiqni pëlqimin tuaj ose kërkonit që të Dhënat tuaja të Studimit të fshihen, ne përsëri mund të mbledhim, përdorim dhe ndajmë ligjërisht të Dhënat tuaja të Studimit deri në momentin që ju tërhiqni pëlqimin ose kërkonit fshirjen e të dhënave tuaja. Edhe nëse e tërhiqni pëlqimin tuaj, ne përsëri mund të përdorim të Dhënat tuaja të Studimit që janë anonimizuar duke hequr çdo të dhënë që ju identifikon. Ne gjithashtu mund të përdorim dhe ndajmë të Dhënat tuaja të Studimit që janë pseudonimizuar duke hequr emrin tuaj dhe disa identifikues të tjerë, në mënyrë që të dhënat të mos ju identifikojnë drejtpërdrejt, kur lejohet nga ligji. Të dhënat tuaja të anonimizuara ose të pseudonimizuara mund të përdoren për qëllime të: (a) shëndetit publik (p.sh., sigurimit të cilësisë dhe sigurisë së lartë të kujdesit shëndetësor dhe/ose barnave ose pajisjeve mjekësore), (b) kërkimit shkencor ose historik ose analizës statistikore siç lejohet nga ligjet e BE-së ose të Shteteve Anëtare të BE-së, dhe (c) ruajtjes ose depozitimit për arsye të rëndësishme të interesit publik. Ne do t'i mbajmë të Dhënat tuaja të Studimit në formë të identifikueshme nëse kërkohet nga ligji.

Nuk ka kufi për kohëzgjatjen se sa do t'i mbajmë të Dhënat tuaja të Studimit për këtë kërkim, sepse ato mund të analizohen për shumë vite. Ne gjithashtu do t'i mbajmë të Dhënat tuaja të Studimit për të përmbushur kërkesat tona ligjore dhe rregullatore. Do t'i mbajmë ato për aq kohë sa janë të dobishme, përveçse kur ju vendosni se nuk dëshironi më të merrni pjesë. Ju po lejoni qasje në këtë informacion pa afat, për aq kohë sa nuk e tërhiqni pëlqimin tuaj.

INFORMACIONI I KONTAKTIT:

Pyetjet: Nëse keni ndonjë pyetje, shqetësim ose ankesë rreth këtij kërkimi, procedurave, rrezeve dhe përfitimeve të tij, kontaktoni Drejtorin e Protokollit, Ari Y Kelman, aykelman@stanford.edu, (650) 723-0792.

Kontakti i Pavarur: Nëse nuk jeni të kënaqur me mënyrën se si po zhvillohet ky studim, ose nëse keni ndonjë shqetësim, ankesë ose pyetje të përgjithshme rreth kërkimit ose të drejtave tuaja si pjesëmarrës, ju lutemi kontaktoni Bordin Institucional të Rishikimit (IRB) të Universitetit Stanford për të folur me dikë të pavarur nga ekipi kërkimor në 650-723-2480 ose falas në 1-866-680-2906, ose me email në irbnonmed@stanford.edu.

Me lejen tuaj, intervista ose biseda do të regjistrohet me audio. Nëse nuk dëshironi të regjistroheni me audio, ju lutemi tregojani këtë kërkuesit. Ju mund të merrni pjesë përsëri pa u regjistruar me audio.

Me lejen tuaj, intervista ose biseda do të regjistrohet me video. Nëse nuk dëshironi të regjistroheni me video, ju lutemi tregojani këtë kërkuesit. Ju mund të merrni pjesë përsëri pa u regjistruar me video.

STANFORD UNIVERSITY Fleta Informacionit Kërkimor

Drejtuesi
Protokollit:: Ari Kelman

IRB Use Only

Approval Date: July 15, 2026
Expiration Date: Does Not Expire

Titulli Protokollit: Good Faith Tech?

IRB# 86294

Me lejen tuaj, kërkuesit mund të mbajnë shënime në terren gjatë ose pas një interviste, bisede, vëzhgimi ose vizite në terren. Këto shënime mund të përdoren për qëllime kërkimore. Nëse kërkuesit dëshirojnë të lidhin vëzhgimet për ju me intervistën tuaj ose me informacione të tjera që jepni, ata do t'ju kërkojnë lejen.

Me lejen tuaj, kërkuesit mund t'ju fotografojnë ose regjistrojnë me video ju, ose objekte, aktivitete, rite ose hapësira të lidhura me pjesëmarrjen tuaj. Nëse nuk dëshironi të fotografoheni ose regjistroheni me video, ju lutemi tregojani këtë kërkuesit. Ju mund të merrni pjesë përsëri në pjesë të tjera të studimit.

Kërkuesit mund të fotografojnë ose regjistrojnë me video gjithashtu hapësira, evenimente, objekte, rite ose aktivitete në grup ku individët nuk janë të identifikueshëm. Nëse dikush kapet rastësisht në një fotografi ose video dhe nuk ka dhënë leje për t'u fotografuar ose regjistruar me video, kërkuesit do të fshijnë, kur është e mundur, imazhin ose regjistrimin, do të bëjnë një version tjetër pa individë të identifikueshëm, ose do të heqin informacionin identifikues, për shembull duke turbulluar fytyrat ose tipare të tjera identifikuese.

Me lejen tuaj, regjistrimet, fotografitë ose videot e identifikueshme nga ky studim mund të përdoren për prezantime kërkimore ose qëllime edukative. Nëse nuk pajtoheni me këtë, ju lutemi tregojani këtë kërkuesit. Regjistrimet, fotografitë ose videot e identifikueshme nuk do të ndahen publikisht pa lejen tuaj shtesë të shprehur qartë.

Ju lutemi ruani ose printoni një kopje të kësaj faqeje për arkivin tuaj. Ju jepni pëlqimin për mbledhjen, përdorimin dhe transferimin e të Dhënave tuaja të Studimit, të cilat përfshijnë të dhëna shëndetësore dhe të dhëna të tjera personale të ndjeshme, për qëllim të kryerjes së studimit kërkimor dhe e dini se mund ta tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë, pas së cilës ne do të ndalojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale, përveç rasteve të përshkruara më sipër.

Nëse pranoi të merrni pjesë në këtë kërkim, ju lutemi tregojani këtë kërkuesit.